

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 nga Udhëzimi për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4887/1 datë 21.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-245/6 datë 22.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 2-të mbajtur më 21.01.2025, miratoi si vijon:

### **Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkeljen e kryer të nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, të transmetuar më 4 nëntor 2024, nuk ka ofruar informacionin që duhet t'u vihen në dispozicion përdoruesve.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4887/1 datë 21.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veproj sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratim llogaritet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

### **Arsyetim**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) ka kompetenca të kryen mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Media, LSHMAAV dhe dispozitave të miratuara në bazë të Ligjit.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur ka cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 51, paragrafi (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuele duhet që përdoruesve t'u mundësojnë qasje të lehtë, të drejtpërdrejt dhe të vazhdueshme së paku për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual, respektivisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e identifikimit personal të shkurtuar (avizo, ligo të ngjajshme); adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual; të dhënat për kontakt me ofruesin e shërbimit mediatik audio ose audiovizual (numër telefoni, e-mail adresë (postës elektronike) dhe/ose ueb-faqes, personi për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe nëse është e mundur dhe të organit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 21 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 4 nëntor 2024, në nivel lokal, ku është konstatuar shkelje e nenit 51, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Pikërisht, me mbikëqyrje është konstatuar se më 4 nëntor 2024, SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, respektivisht nuk u mundësoj qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme së paku për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual; të dhënat për kontakt (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb-faqes; personit përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4887/1 datë 21.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar më 25.11.2024, dërgoj Shkresë ark.nr.10-4887/2 datë 25.11.2024, ku i dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4887/1 datë 21.11.2024, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklarament me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 27.11.2024. Në afatin e parashikuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 21.01.2025, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 nga Udhëzimi për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4887/1 datë 21.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-245/6 datë 22.01.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 21.01.2025, miratoi Aktvendim që publikisht paralajmëron SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar dhe detyrohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, vepron sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

**Shtojcë (1):**

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-4887/1 datë 21.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.